



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY

REPUBLIC OF KOSOVA	
ARRU	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
Nr. prot./Prot. Br./ Prot. No.	582
Njësia/Jedinica/Unit	D
Nr. shkrës./Upis. Br./Req. No.	
Detë/Datum/Data	08.09.2026

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, duke u mbështetur në nenin 4 paragrafi 3.1, nenin 16 dhe nenin 17 të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, si dhe në nenin 4, nenin 9, nenin 12 dhe nenin 13 të Rregullores Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, pas shqyrtimit të aplikacionit me nr. 487/DL datë 24.07.2026 të KRU "Prishtina" Sh.A., me seli në Prishtinë, për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, me datën 08.09.2026, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit

1. APROVOHET aplikacioni me nr. 487/DL datë 24.07.2026, i KRU "Prishtina" Sh.A., për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit.
2. PËRTËRIHET/VAZHDOHET Licenca e Shërbimit e KRU "Prishtina" dhe i lëshohet Licenca e Shërbimit me nr. 09/2026-01, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031.
3. KRU "Prishtina" me Licencën e Shërbimit nr. 09/2026-01, autorizohet për ofrimin e shërbimeve, sipas kategorive në vijim:
 - 3.1. Kategoria A – Shërbimet e Ujësjellësit;
 - 3.2. Kategoria B – Shërbimet e Kanalizimit;
 - 3.3. Kategoria C – Shërbimet e Ujërave të Ndotura;
4. KRU "Prishtina" autorizohet të ofrojë shërbimet për të cilat licencohet në zonën e shërbimit, e cila përfshin komunat:
 - 4.1. Prishtinë;
 - 4.2. Podujevë;
 - 4.3. Fushë Kosovë;
 - 4.4. Lipjan;
 - 4.5. Drenas;
 - 4.6. Obiliq;
 - 4.7. Shtime dhe
 - 4.8. Graçanicë;
 - 4.9. Vushtrri – vetëm vendbanimet Stanoc i Poshtëm dhe Prelluzhë.
5. KRU "Prishtina" Sh.A., obligohet që shërbimet për të cilat licencohet t'i ofrojë në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, Rregulloren Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit, aktet e nxjerra nga ARRUE dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

6. KRU "Prishtina" Sh.A., gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Licencës së Shërbimit, obligohet të ruajë dhe përmbushë kushtet dhe kriteret mbi bazën e të cilave është bërë përtëritja/vazhdimi i Licencës së Shërbimit.
7. KRU "Prishtina" Sh.A obligohet të zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Memorandumi i Mirëkuptimit, i bashkëngjitur këtij vendimi, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara në të, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmbushjen e tyre brenda afateve të parapara.
8. Licenca e Shërbimit me nr. 09/2026-01, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe përbën pjesë përbërëse të tij.

A R S Y E T I M

KRU "Prishtina" Sh.A., si ofrues i licencuar i shërbimeve të ujit, ka paraqitur pranë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) aplikacionin për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit, së bashku me dokumentacionin dhe dëshmitë përkatëse të kërkuara për zhvillimin e procedurës së licencimit.

Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurën dhe kushtet për aplikimin dhe përtëritjen e licencës së shërbimit, ndërsa Rregullorja Nr. 16/2025 për Licencimin dhe Kushtet e Licencës për Ofruesit e Shërbimeve të Ujit përcakton procedurat, kriteret dhe kushtet konkrete për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit. Në veçanti, neni 12 i Rregullores Nr. 16/2025 përcakton kushtet për përtëritjen/vazhdimin e licencës së shërbimit, përfshirë përmbushjen e kushteve të licencës ekzistuese dhe qëndrueshmërinë financiare të ofruesit, ndërsa neni 13 përcakton vendimmarrjen e Autoritetit pas shqyrtimit të aplikacionit.

Në zbatim të dispozitave të lartcekura, aplikacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nga KRU "Prishtina" Sh.A., i janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit nga Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit, i formuar nga ARRU për këtë qëllim. Komisioni, në kuadër të mandatit të tij, ka shqyrtuar dhe vlerësuar aplikacionin, ka verifikuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka vlerësuar përmbushjen e kushteve të licencës, kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për përtëritjen/vazhdimin e saj, përfshirë kapacitetet profesionale, teknike, operative, financiare dhe administrative të aplikuesit.

Gjatë procesit të shqyrtimit është vlerësuar përmbushja e kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, përfshirë kapacitetet profesionale, menaxhuese, operative, teknike dhe administrative, qëndrueshmërinë financiare, përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve në zonën e shërbimit, përmbushjen e kushteve të licencës ekzistuese, si dhe posedimin e lejeve, pëlqimeve, autorizimeve dhe dëshmimeve të nevojshme nga autoritetet kompetente. Këto elemente janë përfshirë edhe në shqyrtimin aktual të aplikacionit të KRU "Prishtina" Sh.A.

Në kuadër të shqyrtimit të dokumentacionit është konstatuar se, për shkak të ndryshimeve në emërtimin dhe regjistrimin e objekteve të KRU "Prishtina" Sh.A., mbetet për t'u kompletuar dokumentacioni përkatës me dëshmitë për plotësimin e kushteve higjieno-sanitare nga Inspektorati Sanitar i Kosovës për objektet përkatëse. Lidhur me këtë, KRU "Prishtina" Sh.A., ka paraqitur dëshmi për veprimet e ndërmarra pranë Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) për regjistrimin e objekteve, me qëllim të vazhdimit të procedurave për pajisjen me dëshmitë përkatëse higjieno-sanitare.

Duke pasur parasysh se në rastin konkret bëhet fjalë për përtëritjen/vazhdimin e licencës së një ofruesi ekzistues të licencuar dhe jo për licencim për herë të parë, si dhe duke marrë parasysh natyrën e dokumentacionit që mbetet për t'u kompletuar dhe veprimet e ndërmarra nga KRU "Prishtina" Sh.A., është vlerësuar se kompletimi i këtyre dëshmive mund të verifikohet edhe në vazhdim, gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës së përtëritje/vazhduar. Për rrjedhojë, KRU "Prishtina" Sh.A., mbetet e obliguar të kompletojë dëshmitë përkatëse higjieno-sanitare, ndërsa përmbushja e këtij detyrimi do të verifikohet nga ARRU gjatë monitorimit të përmbushjes së kushteve të Licencës së Shërbimit.

Në kuadër të vlerësimit të kushteve teknike dhe operative për ofrimin e shërbimeve, është marrë në konsideratë edhe problematika e evidentuar në periudha të caktuara në sistemin e furnizimit me ujë nga Liqeni i Badovcit, lidhur me paraqitjen e përqendrimeve të rritura të manganit dhe ndikimin e kësaj dukurie në cilësinë e ujit të furnizuar për konsumatorët. Duke marrë parasysh rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe vazhdimësisë së furnizimit me ujë, KRU "Prishtina" Sh.A., obligohet që, në kuadër të përgjegjësisë të saj si ofrues i licencuar, të planifikojë dhe të ndërmarrë me kohë masat e nevojshme teknike, operative dhe organizative për parandalimin dhe menaxhimin e kësaj dukurie, me qëllim të minimizimit të ndikimit të saj në cilësinë e ujit të furnizuar për konsumatorët. Zbatimi dhe efektiviteti i masave të ndërmarra do të verifikohen nga ARRU gjatë monitorimit të përmbushjes së kushteve të Licencës së Shërbimit.

Në përputhje me nenin 4 të Rregullores Nr. 16/2025, licencimi i ofruesve të shërbimeve të ujit bëhet sipas kategorive të shërbimeve të përcaktuara nga Autoriteti. Në bazë të aplikacionit dhe dokumentacionit të shqyrtuar, KRU "Prishtina" Sh.A., autorizohet për ofrimin e kategorive të shërbimeve të përcaktuara në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit është vlerësuar zona e shërbimit të KRU "Prishtina" Sh.A., Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, KRU "Prishtina" Sh.A., autorizohet të ofrojë shërbimet për të cilat licencohet në zonën e shërbimit të përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Pas përfundimit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacionit, dokumentacionit dhe dëshmive të paraqitura, Komisioni për shqyrtimin e aplikacioneve për përtëritjen/vazhdimin e licencave të shërbimit ka vlerësuar se KRU "Prishtina" Sh.A., i plotëson kushtet dhe kriteret për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit dhe, rrjedhimisht, i ka rekomanduar ARRU-së përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të KRU "Prishtina" Sh.A., duke përcaktuar njëkohësisht çështjet që do të jenë objekt i verifikimit dhe monitorimit gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

ARRU, duke marrë për bazë aplikacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, rezultatet e procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit, përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore dhe rregullative, si dhe rekomandimin e Komisionit, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për përtëritjen/vazhdimin e Licencës së Shërbimit të KRU "Prishtina" Sh.A., dhe për lëshimin e Licencës së Shërbimit nr. L-09/2026-01, për periudhën pesë (5) vjeçare, nga data 11.09.2026 deri më 10.09.2031, me obligimet e përcaktuara në dispozitiv të këtij vendimi, përmbushja e të cilave do të jetë objekt i monitorimit nga ARRU gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës.

Për arsytet e cekura më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin Shqyrtues, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi u dorëzohet:

- Arkivit të ARRU-së;
- KRU "Prishtina" Sh.A.;
- Të gjitha Departamenteve të ARRU;
- Njesisë për Inspektim.



Zv. Drejtori

Abedin AZIZI